

SYNCRETIZATION OF CASES IN ALBANIAN AND LATIN SINKRETIZMI I RASAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE NË GJUHËN LATINE

Shejnaze AJDINI-MURTEZI¹, Hidajete AZIZI²

^{1*} *Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje*

² *Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje*

**Corresponding author e-mail: sheajdini@hotmail.com*

Abstract

Despite the changes that have occurred as a result of the internal development of the Albanian and Latin languages over the centuries, they have retained many common features of the ancient Indo-European language. This paper which is based on the principles of the contrast method presents an attempt to analyze them and compare the case forms in Albanian and Latin, respectively the impact of the phenomenon of case syncretization in order to notice the similarities and differences between these two languages. In this way we will see the state of each language by clearly defining the characteristics inherited from the Indo-European language as well as the changes that characterize these two languages in terms of the number of cases and the phenome of syncretization of several cases.

Indo-European had a case system meaning eight cases, preserved in the Sanskrit language. The number of cases in Albanian and compared to those of the Indo-European language, has decreased, so that the Albanian language also has five cases: nominative, genitive, dative, accusative and ablative, while the Latin language has six: cases: nominative, genitive, dative, accusative, vocative and ablative.

Although syncretize has affected all languages at all stages of their development, both those which have reduced the number of cases and those witch have preserved the case system the most, its influence is not the same everywhere. Based on this finding, the paper in question will highlight data about on how much and how syncretization has influenced the reduction of cases in the respective languages compared to the old case system of the Indo-European language, as well as which cases have undergone the process of syncretization in Albanian and which in Latin.

Keywords: *case, syncretization, albanian, latin, language, compared.*

Përmbledhje

Përkundër ndryshimeve që kanë ndodhur si rezultat i zhvillimit të brendshëm të gjuhës shqipe dhe gjuhës latine gjatë shekujve, ato kanë ruajtur edhe shumë karakteristika të përbashkëta nga gjuha e vjetër indoevropiane. Ky punim i cili mbështetet në parimet e metodës historiko-komparative dhe metodës kontrastive paraqet një përpjekje për t'i analizuar dhe krahasuar format rasore në gjuhën shqipe dhe në gjuhën latine, gjegjësisht ndikimin e dukurisë së sinkretizmit të rasave, me qëllim që të vërehen ngjashmëritë dhe dallimet midis këtyre dy gjuhëve. Kështu do të shohim gjendjen e secilës gjuhë duke i përcaktuar qartë karakteristikat e trashëguara nga gjuha indoevropiane si edhe ndryshimet që i karakterizojnë këto dy gjuhë sa i përket numrit të rasave dhe dukurisë së sinkretizmit të disa rasave.

Indoevropianishtja kishte një sistem rasor me tetë rase, të ruajtura në gjuhën sanskrite. Numri i rasave, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën latine, duke i krahasuar me ato të gjuhës së vjetër indoevropiane, është pakësuar, kështu që gjuha shqipe numëron pesë rase: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore, kurse gjuha latine numëron gjashtë rase: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, thirrrore dhe rrjedhore.

Megjithëse sinkretizmi i ka prekur të gjitha gjuhët në të gjitha shkallët e zhvillimit të tyre, si ato që e kanë reduktuar numrin e rasave, ashtu edhe gjuhët që e kanë ruajtur më shumë sistemin rasor, ndikimi i tij nuk është

gjithkund i njëjtë. Mbështetur në këtë konstatim, punimi në fjalë do të nxjerrë në pah të dhëna në lidhje me atë se sa dhe si ka ndikuar sinkretizmi në pakësimin e rasave në gjuhët përkatëse në krahasim me sistemin e vjetër rasor të gjuhës indoevropiane, si edhe cilat rase i janë nënshtruar procesit të sinkretizmit në gjuhën shqipe dhe cilat në gjuhën latine.

Fjalët kyçe: rasat, sinkretizmi, shqipe, latine, gjuhë, krahasuar.

1. Hyrje

Kategoria e rasës është njëra nga kategoritë më me interes për studimin e gjuhëve në planin diakronik. Indoevropianishtja ka pasur një sistem rasor me tetë rase, të ruajtura në gjuhën sanskrite: emëroren për kryefjalën; thirroren për të shënuar thirrorin, gjegjësisht personin të cilit i drejtohet folësi; gjinoren për të shprehur përcaktorin emëror; dhanoren për të shprehur kundrinorin e zhdrejtë; kallëzoren për të shprehur kundrinorin e drejtë dhe për të shënuar drejtimin kah synojmë të shkojmë/lëvizim; vendoren për të treguar vendin ku ndodhemi; rrjedhoren për origjinën, vendin nga vijmë dhe instrumentalin për të shprehur rrethanorët e mjetit dhe të shoqërimit.

Në këtë punim do të synojmë që të vëmë në pah gjendjen e të dyja gjuhëve përkatëse, gjegjësisht, të shqipes dhe të latinishtes, duke i përcaktuar karakteristikat e trashëguara nga gjuha indoevropiane dhe ndryshimet që i kanë pësuar ato sa i përket numrit të rasave si pasojë e veprimit të sinkretizmit. Në këtë rast, do të jepen të dhëna për mënyrën se si ka ndikuar dukuria e sinkretizmit në pakësimin e rasave në këto dy gjuhë në krahasim me sistemin e vjetër rasor të gjuhës indoevropiane, dhe të dhëna për rasat konkrete të cilat i janë nënshtruar këtij veprimi.

Për arritjen e këtij qëllimi, përveç literaturës së cituar në punim, si pikë referimi, na kanë shërbyer edhe veprat, si: (Caesar Caius Julius, *De bello civili*, Torino: UTET, Cesar, *La guerre civile*, Livre I (notes accompagnées de traductions partielles) (<https://www.prima-elementa.fr/Auteurs/Ces-cv1a.html#28>); Caesar Caius Julius, *De bello civili*, UTET, Torino, 2008. (Përkthyes në gjuhën shqipe: Nermin Basha); P. Bogdani, *Çeta e Profetëve*, Prishtinë, 1999; M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II (Sintaksa)*, Tiranë, 1957; G. G. Paush, *Gramatika latine*, Prishtinë, 1988 etj.

Numri i rasave në gjuhët përkatëse është pakësuar në krahasim me gjuhën e vjetër indoevropiane. Sot gjuha shqipe numëron pesë rase: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore. Meqë në sistemin gramatikor të gjuhës shqipe është e pranishme edhe kategoria gramatikore e shquarsisë/pashquarsisë dhe emri shoqërohet me një të shquar/të pashquar, edhe numri i formave rasore është më i madh. Për dallim nga gjuha shqipe, gjuha latine numëron gjashtë rase: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, thirrore dhe rrjedhore.

Në këtë gjuhë nuk është e pranishme as nyja e shquar as e pashquar, prandaj edhe numri i formave rasore është më i vogël sesa në gjuhën shqipe. Pra, për secilën rasë ka vetëm nga një formë. Në fakt, në të dyja gjuhët ka më pak forma rasore reale si rezultat i thjeshtësismit që ka të bëjë me bashkimin morfologjik të dy apo më shumë rasave, gjegjësisht të sinkretizmit të rasave. Në vijim do të vihen në dukje rasat të cilat i janë nënshtruar veprimit të sinkretizmit.

2. Sinkretizmi i rasave në gjuhën shqipe

Format rasore, të cilat sipas dëshmimeve të gjuhëve indoevropiane, të dokumentuara me shkrim më herët, ishin tetë, shprehnin lidhjet sintaksike të emrit. Këto forma janë dalluar nëpërmjet mbaresave përkatëse, të cilat i janë shtuar temës së emrit. Në përgjithësi, çdo rasë ka pasur mbaresën e vet, e cila njëkohësisht ka shërbyer si tregues i numrit (Demiraj, 1973, 62). Ndër faktorët kryesorë që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në pakësimin e numrit të rasave në gjuhën

shqipe përmenden: përdorimi gjithnjë e më i shpeshtë i parafjalëve, evolucioni i tingujve fundorë të fjalëve dhe veprimi rrafshues i analogjisë.

Sa i përket sistemit të lakimit të gjuhës shqipe dihet mirëfilli se edhe me sinkretizmin morfologjik të disa rasave gjatë Mesjetës, siç dëshmohet në tekstet e vjetra, paraqiten shtatë rasa: emërorja, gjinorja dhanorja, kallëzorja, thirrorja, vendorja dhe rrjedhorja. „As nga fragmentet parabuzukjane deri më sot të njohur, as nga reliktet gjuhësore të zbuluar deri më sot nuk bëhet e besueshme që sistemi lakor i shqipes në Mesjetën e vonë të ketë pasur ndonjë rasë më tepër nga ato që paraqiten në shqipen e teksteve të vjetër e për të cilat mendohet përgjithësisht se kanë qenë shtatë: 1) emërorja, 2) gjindorja, 3) dhanorja, 4) kallëzorja, 5) thirrorja, 6) vendorja dhe 7) rrjedhorja“ (Riza, 1965, 10). Edhe pse sqarimi historik i sistemit rasor të gjuhës shqipe ishte qëllim qenësor i shumë gjuhëtarëve dhe albanologëve, duke filluar nga Bopp-i, Skok-u, Pedersen-i, Jokl-i, Desnickaja, Bariç-i, Çabej, Riza, Demiraj, Bokshi dhe të tjerë, në përgjithësi pranohet se çështja e numrit të rasave mbetet ende e pasqaruar tërësisht.

Kjo, nga arsyeja se krahas veprimit të sinkretizmit që ka ndikuar në pakësimin e numrit tyre, është krijuar edhe lakimi i dyfishtë (i shquar dhe i pashquar), i cili ka ndikuar në dyfishimin e formave rasore. Megjithatë, këtu duhet theksuar se numri i formave rasore të njëjësit nuk është i barabartë me ato të shumës. Në njëjës është ruajtur dallimi i formave rasore sipas gjinisë, ndërsa në shumës ka vepruar sinkretizmi duke krijuar mbaresa të përbashkëta për të tri gjinitë. Sinkretizmi nuk ka vepruar njësoj as në të dy trajtat.

Konsiderohet se sinkretizmi i rasave në shqipen e dokumentuar ka ndodhur që nga rënia dhe reduktimi i tingullit fundor të mbaresës emërore rasore indoevropiane. Format e thirrores dhe instrumentalit janë zhdukur. Pas shfaqjes së sistemit të nyjave shquese në gjuhën shqipe, funksionin e thirrores e kryen jo vetëm emërorja e pashquar, por edhe e shquara, në rastin kur kjo ndiqet nga një përcaktor individualizues: *o bir... o biri i nënës*; kurse funksionin e instrumentalit e kryen kallëzorja parafjalore dhe rrjedhorja.

Në lidhje me këtë, Eqrem Çabej thekson se „*Lakimi i shqipes ka pësuar ndryshime të mëdha sidomos në sistemin e rasave, kështu ndër të tjera, siç ka vënë re Pedersen, humbjen e instrumentalit; më anë tjetër ka pasur formime të reja, ndër to të ashtuquajturën vendore (lokativ) me -t njëjës, e më në fund ka ndodhur një sinkretizëm i shpeshtë, një përzierje e rasave, e mbaresave dhe e funksioneve të tyre...*“ (1955, 46). Nëse vendorja do të veçohet si një krijim i ri në sistemin e lakimit të gjuhës shqipe, i cili tani është i kufizuar vetëm në përdorime sporadike, dhe nëse veçohet edhe thirrorja, atëherë mbeten pesë rasa (Ajeti, 1985, 107).

Rasa rrjedhore në numrin shumës ka marrë mbaresën e rasës vendore, ndërsa funksionet e kësaj të fundit i kryen kallëzorja parafjalore dhe rrjedhorja. (Topalli, 2009, 48). Sinkretizmi ka vepruar, gjithashtu, edhe në trajtën e pashquar njëjës të emërores dhe kallëzores, ashtu që është krijuar një formë e njëjtë për të dy rasat, ndërsa në trajtën e shquar nuk ka vepruar sinkretizmi, që do të thotë se kemi forma të veçanta për të dy rasat. Arsytet e njëjtësisht të formave rasore të emërores dhe kallëzores i studiuuan dhe i analizuan një numër i madh gjuhëtarësh. Parashtrohej pyetja: nëse shkak i njëjtësisht të formave rasore ishte shfaqja e një sinkretizmi të vërtetë, apo rënia e tingujve në fund të fjalës?

Në historinë e shqipes paraletre njëjtësimi morfologjik i kallëzores së një emri të gjinisë mashkullore apo femërore me emëroren përkatëse nuk ka qenë dukuri e një sinkretizmi të vërtetë, por një bashkëndeshje tingullore (Riza, 1965, 11). Njëjtësimi i kallëzores me emëroren rrjedh nga zhdukja, gjegjësisht dobësimi i tingujve fundorë të trajtave përkatëse. Sipas tezës së Norbert Jokl-it (Ajeti, 1986, 109), njëjtësimi analog i emërores dhe kallëzores në gjininë femërore ka ndikuar në njëjtësimin e emërores dhe kallëzores në gjininë mashkullore, si për shembull, nga gjinia femërore *punë >punë*, në gjininë mashkullore kemi *shteg>shteg* në vend të *shtegë >shteg*, duke u nisur nga

tema e kallëzores së emrave të gjinisë mashkullore të cilët gjithashtu kanë kaluar edhe te rasa emërore.

Edhe pse teza e Jokl-it është pranuar, ky sqarim nuk është i vetëm, që do të thotë se ende ka hapësirë edhe për teza të tjera të mundshme. Kështu, në lidhje me këtë, Çabej thekson se emrat *djalë, gjumë, lumë, burrë* mund të rrjedhin pjesërisht nga gjinia asnjëse ose nga gjinia femërore dhe pjesërisht mund të jenë forma analoge. Rrugët nëpër të cilat është kryer njësimi i formave rasore të emërores e kallëzores janë dy: në disa emra, forma e rasës emërore pa mbaresë është shtrirë në formën e rasës kallëzore (*lis ~ *lisë = lis ~ lis*), kurse në disa emra të tjerë forma e rasës kallëzore me mbaresën -ë është shtrirë në formën e rasës emërore (**gjum~gjumë = gjumë ~ gjumë*) (1960, 9-82).

Por kjo lëvizje e brendshme nuk është kryer në mënyrë kaotike, sepse gjuha vepron kudo sipas rregullave dhe prirjeve të veta që i kanë shkaqet e tyre. Me këtë lëvizje shpjegohet edhe humbja e zanores -ë pastheksore në trup të fjalës në trajtën e vjetër të shquar **ulkënë* (nga **ulkon-tan*), pasi kallëzorja e re u ndërtua nga trajta e emërores pa mbaresë, që u shtri edhe në rasën kallëzore (*ulk-në*). Zhdukja e kësaj zanoreje në këtë formë nuk është bërë me rrugë fonetike, por me rrugë morfologjike, duke u zëvendësuar tema e kallëzores së vjetër me -ë me temën e re pa këtë zanore, që vinte nga rasa emërore (Topalli, 2009, 144).

Nga kjo që u tha më lart, me gjasë, mund të konstatohet se mbaresa e rasës kallëzore e numrit njëjës nuk ka rënë me rrugë fonetike, por është zhdukur me rrugë morfologjike, nga sinkretizmi i rasave emërore e kallëzore. Në shqipen e dokumentuar, me të njëjtat mbaresa rasore dalin edhe gjinorja e dhanorja, si në trajtën e pashquar ashtu edhe në të shquarën. Megjithatë, rasa gjinore dallohet nga rasa dhanore jo vetëm për nga funksionet, por edhe nëpërmjet «njës së përparme». Për shembull, në njëjës kemi: (*një*) *libr-i ~ i (një) libr-i, libr-it ~ i libr-it* dhe shumës: (*ca*) *male-ve ~ i (ca) male-ve, male-ve(t) ~ i male-ve(t)*. Është pranuar mendimi që mbaresat rasore të gjinores njëjës në fillim i kanë takuar dhanores dhe që më vonë kanë kaluar edhe te gjinorja, kurse në shumës ka ndodhur e kundërta: mbaresa rasore e gjinores ka kaluar edhe te dhanorja. Nën veprimin e sinkretizmit, këtyre rasave u është bashkëngjitur edhe rrjedhorja.

Njësimi i këtyre tri rasave në njëjës del si pasojë e proceseve fonetike si edhe e analogjisë gramatikore. Kjo dukuri ka ndikuar edhe në shumës, ashtu që format e gjinores dhe dhanores, sipas analogjisë së numrit njëjës, e përfshijnë edhe rrjedhoren në trajtën e shquar (Demiraj, 1986, 253). Në gjuhën letrare shqipe është vënë normë që rrjedhorja të ketë mbaresën -sh në trajtën e pashquar (Kostallari, 44 - 48). Edhe pse përdorimi i mbaresës -sh është i domosdoshëm në konstruktet e llojit *emër+emër* (përcaktues në rrjedhore), përsëri duhet përmendur se ka tendencë të njësimi të mbaresës së rrjedhores me mbaresën e gjinores dhe dhanores, ashtu që mund të përdoret edhe mbaresa -ve për rrjedhoren, sidomos në përputhshmëri me parafjalët.

Mbaresat e tjera rasore të rrjedhores njëjës janë të njëjta me ato të dhanores si pasojë e sinkretizmit të këtyre dy rasave. Pikërisht, për këtë arsye, vështirësitë e analizimit të kësaj rase janë të mëdha, e posaçërisht përshkak të ndryshimit të funksioneve në dy drejtime: nga njëra anë, ngushtimi i funksioneve të saj në rastet kur ajo përdoret pa parafjalë dhe, nga ana tjetër, zgjerimi i funksioneve të saj në rastet kur përdoret me parafjalë. Në vend të formës së rrjedhores së shquar të llojit *bjeshkësh-i-t*, në shekujt e fundit ka filluar të përdoret gjithnjë e më shpesh forma e dhanores së shquar shumës *bjeshkëve(t)*. Forma rasore *bjeshkësh-i-t* në gjuhën e sotme shqipe nuk përdoret aspak.

Zëvendësimi i formës arkaike të rrjedhores së shquar njëjës *bjeshkësh-i-t* me dhanoren e shquar të llojit *bjeshkëve-t* duket të jetë kryer nën veprimin analogjik të formave përkatëse të këtyre rasave në njëjës, ku ato paraqiten si homonime jo vetëm në trajtën e shquar, por edhe në të pashquarën. Zhdukja e formës arkaike të rrjedhores së shquar shumës, gjegjësisht sinkretizmi i saj

me dhanoren e shquar shumë ka ndikuar që me kohë edhe forma e rrjedhore shumë e llojit *bjeshkë-sh* të zëvendësohet gradualisht me dhanoren e pashquar *bjeshkëve*. Për zhdukjen e shkallëshkallshme të rrjedhore së pashquar, rol mjaft të rëndësishëm duhet të ketë pasur homonimia e formave të dhanores dhe rrjedhore në trajtën e pashquar njëjës.

Ky zëvendësim është i pamundur vetëm në sintagmat e llojit *lule dhensh* si dhe në ndërtimet e llojit *gjithfarë (lloj-lloj, çfarë) njerëzish* (Demiraj, 1986, 371). Zhdukja e plotë e rrjedhore në trajtën e shquar në gjuhën letrare shqipe në dy shekujt e fundit është bërë shkak për kufizimin e përdorimit të kësaj rase edhe në trajtën e pashquar. Edhe pse në tekstet e vjetra të gjuhës shqipe, rrjedhorja, si në trajtën e shquar ashtu edhe në atë të pashquar, ka ekzistuar si formë e plotë dhe ka pasur funksion të pakufizuar, sikurse edhe rasat e tjera (emërorja, gjinorja, dhanorja dhe kallëzorja), megjithatë mund të pohohet se para periudhës së Rilindjes ajo nuk paraqitej si trajtë e plotë në sistemin rasor (Riza, 1965, 42). Kjo do të thotë se rrjedhorja është pjesë përbërëse e këtij sistemi dhe paraqet vetëm një formë me karakter reliktor.

Kurse, sa i përket mbaresës *-sh* të rrjedhore shumë, në format e tipit *male-sh, fusha-sh*, që nga Bopp-i e këtej është pranuar se ajo është refleksi i mbaresës indoevropiane *-su* të rasës vendore shumë. Përdorimi i kësaj forme me vlerë vendoreje është ende i gjallë nëpër disa të folme veriore, si p.sh. në ndërtime *ra borë malesh* të gegërishtes veriore, e cila me kalimin e kohës është përdorur me funksionin e rrjedhore e më vonë edhe të gjinore.¹⁰⁷ Në gramatikat e gjuhës shqipe rrethanori i vendit është shprehur me kallëzoren e paraprirë nga parafjalë *në* (Çeliku, 1997, 292).

3. Sinkretizmi i rasave në gjuhën latine

Gjuha latine ka trashëguar një sistem rasor nga indoevropianishtja e cila numëronte tetë rase. Përveç gjashtë rasave: emërore, thirrore, kallëzore, gjinore, dhanore dhe rrjedhore, ajo njihje gjithashtu edhe vendoren (lokativin) dhe instrumentalin. Për këtë arsye, në gjuhën latine rrjedhorja është ngarkuar ta kompensojë zhdukjen e rasave të humbura, dukuri kjo që siç e theksuam më lart, njihet si sinkretizëm rasor.

Kështu, nëse pesë rasat e tjera paraqesin vlerat që i kishin nga indoevropianishtja, rrjedhorja latine është një rasë sinkretike që përfshin vlera të cilat ishin të rrjedhore së pastër, në kuptimin e plotë të fjalës, të vendores dhe të instrumentalit. [...] në fakt, në sinkroni, plotësi i krahasimit, plotësi i mjetit edhe plotësi i vendit (i cili i përgjigjet pyetjes *ubi?*- ku?), vihen në rrjedhore, ndërsa në diakroni, e para paraqet një «rrjedhore rrjedhore», e dyta një «rrjedhore të mjetit (instrumentalin)», dhe e treta një «rrjedhore vendore» (Nicolas, 2019, 2).

Klasifikim i rasave i bërë nga gramatikanët në librat për qëllime pedagogjike është një shpërndarje praktike, por më shumë artificiale, sepse siç thekson Bouillon,¹⁰⁸ se përkundër gjashtë rasave teorike në të pesë lakimet, asnjëherë nuk kemi gjashtë mbaresa të ndryshme. Format identike të emërores dhe thirrores e kanë origjinën nga gjuha e përbashkët indoevropiane. Emërorja është përdorur shumë herë në vend të thirrores. „*Dans les exclamations on pouvait employer soit le vocatif, soit le nominatif. D'autre part, le vocatif prenait quelquefois la place du nominatif, comme*

¹⁰⁷ Shih për këtë: Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, BUST SSS 4, 1955, f. 117; Shaban Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 287, Kolec Topalli, *Sistemi rasori emrave të shqipes*, 2009, f. 292.

¹⁰⁸ Shih për këtë: Bernard Bouillon, *Morphologie et syntaxe du latin au français*, Fichier de cours pour les étudiants de l'Université d'Artois, 2006, (<http://cours.en.langue.univ-artois.fr/Lettres/hl/fichiers/cours/synt.htm>), konsultuar më 06.05. 2016.

attribut d'un vocatif ". („Në pasthirrma mund të përdorej qoftë thirrorja, qoftë emërorja. Nga ana tjetër, thirrorja ndonjëherë përdorej në vend të emërores, si një atribut i thirrores").¹⁰⁹

Në fakt, vetëm lakimi i dytë është më i plotë për shkak se thirrorja është ruajtur si e ndryshme në emrat e gjinisë mashkullore njëjës të cilët mbarojnë me *-us*, *-i*, siç është emri *dominus* (emërore) i cili posedon një formë të posaçme për thirroren (*domine*), ndërsa në numrin shumës thirrorja dhe emërorja kanë formë të njëjtë rasore (*domini / domini*). Te emrat e lakimit të dytë të gjinisë mashkullore të cilët mbarojnë me *-er*, në fillim, emërorja dhe thirrorja dalloheshin ndërmjet tyre në bazë të gjatësisë së zanores *-e*, pra emërorja me zanore të gjatë *-ē* (*magistēr*), kurse thirrorja me zanore të shkurtër *-ĕ* (*magistĕr*).

Si pasojë e shkurtimit të zanores *-e* në rrokjen fundore me *-er*, emërorja dhe thirrorja janë njëjtësuar që në latinishten klasike (*magistēr / magistĕr*). Në lakimet e tjera, thirrorja është e përzier me emëroren, gjegjësisht ka formë të njëjtë me emëroren. Gjithashtu, këtu duhet shtuar se në gjininë asnjane thirrorja është identike me emëroren dhe kallëzoren në të dy numrat, në njëjës dhe në shumës (*templum - templa,...*), si rezultat i sinkretizmit të këtyre rasave.

Në latinishten klasike, gjinorja është e njëjtë me emëroren në temat që mbarojnë me *-i*, për shembull, nom/ gen: *civīs*. Supozohet se kjo ngjashmëri nuk rrjedh nga gjuha e vjetër indoevropiane, por kjo është një ngjashmëri e re e cila del nga gjuha latine si pasojë e zëvendësimit të gjinore me temë me bashkëtingëllore, me gjinoren primitive me temë me *-i*. Gjithashtu, ka përputhje midis gjinore dhe dhanore njëjës në lakimin e parë (gen./dat.: *terrae*) (Oštra, 1975, 21).

Megjithatë, nuk mund të konstatohet me siguri se forma e gjinore me *-ae* (*Romae, terrae*) ka qenë formë e dhanore së hershme, edhe pse kjo formë identike e të dy rasave është paraqitur edhe në sanskrishten. Derisa në gjuhën sanskrite këto dy rasa ishin ekuivalente, në gjuhën latine kanë përdorime të ndryshme edhe në kuptim posesiv. Kështu gjinorja e pronësisë me foljen *sum* dallohet nga dhanorja e pronësisë. Për shembull:

Liber est Paullī. (Ky libër i përket Palit) - gjinore dhe
Liber est Paullō. (Pali ka një libër) - dhanore.

Në numrin shumës, rrjedhorja dhe dhanorja kanë formë të njëjtë në të gjitha lakimet (dativus/ablativus - lakimi i parë: *rosis* (f); lakimi i dytë: *dominis* (m); *templis* (n); lakimi i tretë: *civibus* (m), *maribus* (n); lakimi i katërt: *manibus* (f); lakimi i pestë: *rebus* (f). Gjithashtu, edhe në numrin njëjës të emrave të lakimit të dytë të gjinisë mashkullore dhe asnjane si dhe të emrave të lakimit të tretë të gjinisë asnjane, tema e të cilëve del me zanoren *-i*, dhanorja dhe rrjedhorja janë të njëjta. P.sh. lakimi i dytë: dativus/ablativus: *domino*(m), *templo*(n) dhe lakimi i tretë dativus/ablativus: *mari*(n), *animali*(n).

Meqë në të gjitha rastet e tjera (te emrat e lak. të parë njëjës, emrat e të tri gjinive të lak. të tretë njëjës, tema e të cilave del me bashkëtingëllore, emrat e lak. të katërt njëjës dhe emrat e lak. të pestë njëjës), dhanorja dhe rrjedhorja dalin me mbaresa të ndryshme, atëherë mund të thuhet se bëhet fjalë për një sinkretizëm të pjesshëm të këtyre dy rasave. Dallimi midis dhanore dhe rrjedhore qëndron në funksionet sintaksike të tyre. Dhanorja përfaqëson kundrinorin e drejtë. Në këtë funksion, në gjuhën shqipe përkthehet gjithashtu me dhanore. P.sh.:

Canem dat filio. (Ai i jep një qen djalit të tij);

¹⁰⁹Shih për këtë: K. Brugmann & B. Delbrück, *Grundriss der vergleichenden grammatik der indogermanischen sprachen II*, Strasbourg, 1897, & 189, p. 523 (<https://archive.org/details/grundrissderver03bruggoog>), konsultuar më 20. 07. 2014.

Epistulam consulibus mittimus. (Ne u dërgojmë një letër konsujve).

Për dallim nga rasa dhanore, rrjedhorja është rasë me më shumë funksione, e veçanërisht si plotës që tregon vendin e:

- prejardhjes: *Epistulam a domino accipimus* (Ne pranuar një letër nga zotëriu);
- të largimit: *Decedo ex urbe* (Unë dal nga **qyteti**);
- të shoqërimit: *Marcus cum cane ambulat* (Marku shëtitet **me qenin** e tij)¹¹⁰ etj.

Rrjedhorja indoevropiane ka qenë fillimisht një rasë konkrete që ka treguar një pikënisje: fjala latine «ablativus ablativus» (rrjedhore rrjedhore) tregon origjinën e një veprimi. Ajo i është përshtatur thelbësisht plotësit të vendit që nënkupton origjinën): *redeō Rōmā* (vij nga Roma). Sinkretizmi e bën rrjedhoren rasën më të ndërlikuar latine. Kuptojmë se vetë latinët kanë pasur vështirësi ta përshkruajnë funksionin e rasës të cilën e quanin *ablativus*, dhe njëkohësisht kanë hezituuar sa i përket përcaktimit të numrit të rasave.

Sa i përket rasës vendore, në gjuhën indoevropiane ajo ka shërbyer kryesisht për të përcaktuar vendin se ku gjendemi, pra, atë që nuk është as origjina e lëvizjes (që shprehet me rrjedhore), as pika e arritjes (që shprehet me kallëzore), por as pika e kalimit. Ndërsa, në gjuhën latine, rasa vendore është zhdukur qysh në periudhën perandorake. Mund të thuhet se ajo paraqet një mbetje dhe ekziston vetëm në mënyrë të ngurtësuar në disa emra të përgjithshëm të vendeve, qyteteve dhe disa ishujve të vegjël, ku i nënshtrohet kriterëve të përcaktuara morfosintaksike: *sum Rōmae* (jam në Romë).

Përndryshe, vendorja pa parafjalë, e trashëguar nga gjuha e vjetër indoevropiane, në të gjitha përdorimet tjera është zëvendësuar me rrjedhoren, e më shpesh me rrjedhoren me parafjalë (Ernout, 1953, 4,5). Për shembull: *In urbe estis* (Ju jeni në qytet). Derisa instrumentali në gjuhën e vjetër indoevropiane shërbente për të karakterizuar mjetin e realizimit të një veprimi apo plotësin e shoqërimit, në gjuhën latine, rrjedhorja e ashtuquajtur «rrjedhore instrumentale» shërben për të shprehur plotësin e mjetit: *ariete moenia ēuerterunt* (ata i rrëzuan muret me një dash); plotësin e shoqërimit: *cum amīcō ambulat* (ai shëtitet me një shok); plotësin e mënyrës, i cili nënkuptohet si një «rrethanë shoqëruese»: *uēnit maximō cum gaudiō* (ai ka ardhur me gëzim të madh) (Nicolas, 2019, 3).

Në temat me *-o*, si në njëjës ashtu edhe në shumës, vendorja, instrumentali dhe rrjedhorja janë të përziera, gjegjësisht është bërë sinkretizmi i këtyre rasave, me ç'rast funksionet e instrumentalit dhe vendores i kalojnë rrjedhores. Instrumentali me *-e* është ruajtur në ndajfoljet e llojit si *facillime* etj.

4. Përfundimi

Siç përmendëm edhe më lart, numri i rasave në të dy gjuhët, duke i krahasuar me gjuhën e përbashkët indoevropiane, është pakësuar. Në gjuhën shqipe ka më pak forma rasore reale si rezultat i reduktimit të mbaresave fundore, analogjisë dhe zgjerimit analog të disa formave në rasa tjera. Gjithashtu, pakësimi i numrit të rasave në gjuhën klasike latine është bërë si pasojë e procesit së thjeshtësimit të lakimit indoevropian, i cili ishte më i pasur me forma të ndryshme morfologjike rasore.

¹¹⁰ Shih për këtë: Jinging Wang, *Déclinaison* (http://www.normalesup.org/~jwang/files/2018/Latin/5datif_ablatif.pdf)

Ky thjeshtësim ka të bëjë me bashkimin morfologjik, gjegjësisht, me procesin e sinkretizmit të dy a më shumë rasave. Kështu, gjuha shqipe ka pesë rase, ndërsa gjuha latine gjashtë. Sistemi rasor i gjuhës latine e ka edhe thirroren e cila në fillim ka qenë jashtë sistemit rasor falë autonomisë sintaksore. Në gjuhën shqipe, gjuhëtarët nuk e kanë pranuar si rasë të veçantë, për shkak të formës së njëjtë me emëroren.

Nga pikëpamja morfologjike, thirrvoja e gjuhës latine dallohet nga emërorja vetëm te emrat e lakimit të dytë të gjinisë mashkullore (thirrje: *popūle* - emërore: *popūlus*), derisa në gjininë asnjansore të lakimit të dytë si edhe në lakimet e tjera del e njëjtë. Pra, sa i përket thirrjes, në gjuhën shqipe, mund të flitet për një sinkretizëm të plotë të saj me emëroren, ndërsa në gjuhën latine sinkretizmi i thirrjes me emëroren është i pjesshëm, për faktin se kjo rasë ka formë të ndryshme nga emërorja te emrat e lakimit të dytë njëjës të gjinisë mashkullore.

Derisa në gjuhën shqipe, gjinorja dhe dhanorja kanë forma të njëjta si në trajtën e shquar ashtu edhe në të pashquarën në të gjitha lakimet, në gjuhën latine përputhje midis këtyre dy rasave ka vetëm në lakimin e parë. Sa i përket rasës dhanore dhe rrjedhore, në gjuhën shqipe mund të flitet për një sinkretizëm pothuajse të plotë të këtyre dy rasave, kurse në gjuhën latine kemi një sinkretizëm të pjesshëm të tyre, nga arsyeja se në disa raste këto dy rase nuk kanë formë të njëjtë.

Në gjuhën latine rrjedhorja konsiderohet si rasë e sinkretizuar, meqë ajo ka mbuluar funksionet e instrumentalit dhe të vendores. Instrumentali ka lënë gjurmët te rrjedhorja e mjetit, e cila shprehet me rrjedhore pa parafjalë, ndërsa në gjuhën shqipe del me kallëzore me parafjalën *me*. Ndërsa, sa i përket vendores së dikurshme, gjegjësisht rrethanorit të vendit, në gramatikat e gjuhës shqipe, ai shprehet me kallëzoren e paraprirë nga parafjala *-në*. Si përfundim i gjithë kësaj mund të themi se sinkretizmi ka vepruar në pakësimin e formave rasore si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë latine.

Referencat

- [1]. Ajeti, I. (1985). *Studime gjuhësore në fushën e shqipe II*, Prishtinë: Rilindja.
- [2]. Ajeti, I. (1986). *Gjurmime albanologjike*, Prishtinë: Rilindja
- [3]. Bokshi, B. (2005). *Rruga e fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë: ASHAK.
- [4]. Çabej, E. (1955). *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, BUST SSS 1, Tiranë.
- [5]. Çabej, E. (1960). *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe I - BUST SSS 4*, Tiranë.
- [6]. Çeliku [et al]. (1997). *Gramatikë e gjuhës shqipe II*, Tiranë.
- [7]. Demiraj, Sh. (1973). *Morfologjia historike e gjuhës shqipe I*, Tiranë.
- [8]. Demiraj, Sh. (1986). *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- [9]. Ernout, A. (1957). *Morphologie historique du latin*, Paris: Klincksieck.
- [10]. Kostallari, A. (1976). *Gjuha letrare shqipe për të gjithë - Elemente të normës së sotme letrare kombëtare*, Tiranë.
- [11]. Oštra, R. (1975). *Sur l'évolution de la flexion nominale dans les langues romanes*, Les Études Romanes de Brno.
- [12]. Topalli, K. (2009). *Sistemi rasori emrave të shqipes*, Tiranë: Plejad.
- [13]. Riza, S. (1965). *Emrat në shqipe: Sistemi i rasave dhe tipet e lakimit*, Tiranë.

Burime nga interneti

- [1]. Bouillon, B. (2006). *Morphologie et syntaxe du latin au français*, Fichier de cours pour les étudiants de l'Université d'Artois, konsultuar më 06.05. 2016 (<http://cours.univ-artois.fr/Lettres/hl/fichiers/cours/synt.html>).
- [2]. Brugmann, K. & Delbrück, B. (1897). *Grundriss der vergleichenden grammatik der indogermanischen sprachen II*, Strasbourg, p. 523, konsultuar më 20. 07.2014 në (<https://archive.org/details/grundrissderv03bruggoog>).
- [3]. Wang, J. (2018). *Déclinaison*, konsultuar më 09.10.2020 në (http://www.normalesup.org/~jwang/files/2018/Latin/5datif_ablatif.pdf).